



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1769/ 7 prot.

Datë 09/08/2024

V E N D I M

Nr. 1015/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09/08/2024, shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me pjesën e pranuar të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

Mbetjen të skualifikuar për arsyet e dhëna nga komisioni i vlerësimit të ofertave për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “XHENGO” SHPK dhe për ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “NDERTUESI 2014” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues: Operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK me NIPT: K61625001I dhe me adresë: *Rruga “Dervish Hekali”, Ndërtesa nr. 8, Tiranë.*

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A
Adresa: Rajoni Nr. 1, Rruga “Boris Plumbi”, Nr. 20 Korçë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK me NIPT: J91915001P dhe me adresë: *Rruga “Abdi Toptani”, Qendra “Torre Drin”, apartamenti 112, kati 11, Tiranë.*

Operatori ekonomik “XHENGO” SHPK me NIPT: J64103171M dhe me adresë: *DON. GJON. BUZUKU, L.5, Korçë.*

Operatori ekonomik “NDERTUESI 2014” SHPK me NIPT: L46827004L dhe me adresë: *Rruga “Daut Boriçi”, zona kadastrale nr. 8594, numri i pasurisë 3/574+2-22, volumi 36, faqe 14, Shkodër.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.04.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

II.2. Në datë 10.05.2024 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 10.06.2024 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1. “XHENGO” SHPK	41.471.905,00 leke	skualifikuar
2. “NDËRTUESI 2014” SHPK	48.762.736,20 leke	skualifikuar
3. “ALMO KONSTRUKSION” SHPK	57.267.724,50 leke	kualifikuar
4. “ED KONSTRUKSION” SHPK	59.473.922,00 leke	kualifikuar
5. “ASI-2A CO” SHPK	61.598.522,33 leke	kualifikuar
6. “NIEM” SHPK	64.280.310,00 leke	kualifikuar
7. “REJ” SHPK	64.296.629,60 leke	skualifikuar
8. “INFINIT” SHPK	67.184.111,58 leke	kualifikuar

II.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 25.06.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “ALMO KONSTRUKSION” SHPK.

II.5. Në datën 01.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2024/4277, datë 01.07.2024, dhe me nr. 1769/2024 prot, datë 01.07.2024, e operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, si më poshtë vijon:

“I. Në këtë procedurë prokurimi kërkojmë të mbetet i skualifikuar operatorët ekonomik “XHENGO” shpk dhe “NDËRTUESI 2014” shpk, të cilët nuk përmbushin kriteret e vendosura për kualifikim sipas refuzimit të kualifikimit të bërë nga Autoriteti Kontraktor.

II. Gjithashtu kërkojmë të skualifikohet operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k, i cili nuk përmbush kriteret e kualifikimit konkretisht nuk plotëson kriteret si më poshtë:

Së pari, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k nuk plotëson kriterin mbi fushën e veprimtarisë sipas objektin të prokurimit ku kjo procedurë prokurimit ka si objekt punime ndërtimi në ujësjellës.

Referuar, Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) në DST e kësaj procedure prokurimi përcaktohet : 45247130-0 Punime ndërtimi për ujësjellës.

Së dyti, referuar edhe sa më sipër, ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e kualifikimit pika 2.3.1 të Kapacitetit teknik ku parashikohet se:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 38.169.344,7 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 152.677.379 lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Në këtë procedurë prokurimi parashikohet kryerja dhe realizimi i punime të një natyre komplekse tilla si: shpim pusi, ndërtim godine pusi, ndërtim linje për furnizimin me energji elektrike të stacionit të pompave (Linja ajorore) etj. Në preventivin e kësaj procedure prokurimi përfshihet ndër të tjera dhe ndërtimi i një pusi dhe sisteme komandimi automatik thënë ndryshe sisteme skada, zëra punimesh për të cilat ky operator për shkak të mungesës të realizimit të punëve të ngjashme nuk disponon kontrata të ngjashme që kanë element të njëjtë apo të ngjashëm me zërat të preventivit si psh: Ngritje sonde, hapja e gropës së dekantimit, punime të tjera dhe kthimi i territorit në identitet, Shpim pusi d=311mm me argjila betonite, Furnizim pompe zhytëse + Sistemi automatik i komandimit etj.

...

Së treti, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” shpk nuk plotëson kriterin mbi 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme të kërkuara. Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi mjetet të kërkuara në shtojcën e publikuar, Shtojca 7/2 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT SHITESË” ku është kërkuar si më poshtë:

Mjetet	Statusi	Sasia
<i>Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

<i>përshatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)</i>		
<i>Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s - kërkohet për tesimin e prurjes minimale dhe maksimale që mund të japë kolona e pusit. Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin) - kërkohet për matjen e prurjes minimale dhe maksimale që mund të japë kolona e pusit.

Shërben gjithashtu dhe për përcaktimin e saktë të regjimit të punës së pompës zhytëse që do të instalohet dhe balancimin mes prurjeve që vijnë në kolonën e pusit dhe atyre që dërgohen në linjën e transmetimit.

Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin) kërkohet për matjen e nivelit dinamik të pusit. Niveli dinamik janë luhatjet e nivelit të ujit në kolonën e pusit. Njohuritë e sakta për nivelin dinamik ndikojnë drejtpërdrejt në shfrytëzimin korrekt të pusit dhe përcaktimin e një regjimi optimal të pompës zhytëse në vazhdim. Këto mjete shpesh janë në përputhje me zërat e punimeve që ndodhen në preventivë. (shkëputur nga Shtojca)

Operator ekonomik " ALMO KONSTRUKSION" SHPK nuk disponon mjetet e mësipërme.

Ky operator ekonomik nuk është veprimtarie të kësaj procedure prokurimi, nuk ka eksperience mbi kryerjen e punëve të ngjashme në drejtimin e objekteve të prokurimit mbi ujësjellës, si dhe

nisur dhe me kohën e publikimit të kësaj shtojce, mbi kërkesën për disponimin e këtyre mjeteve

verteton faktin se operatori i kualifikuar nuk i disponon këto mjete.

Referuar dhe preventivit të punimeve përcaktohet:

<i>Nr</i>	<i>Nr. Analize</i>	<i>Emërtimi i punimeve civile</i>	<i>Njësi</i>	<i>Sasia</i>	<i>Çmimi (lekë)</i>	<i>Vlera (lekë)</i>
		<i>Shpim pusi</i>				
<i>1</i>	<i>An.</i>	<i>Transport i agregatit të shpimit dhe bazës materiale vajtje kthim</i>	<i>ml</i>	<i>120</i>		
<i>2</i>	<i>An.</i>	<i>Punime përgatitore (Ngritje sonde hapja e gropës së dekantimit punime të tjera dhe kthimi i territorit në identitet)</i>	<i>komplet</i>	<i>120</i>		
<i>3</i>	<i>An.</i>	<i>Shpim pusi d=470mm për konduktorin</i>	<i>ml</i>	<i>15</i>		
<i>4</i>	<i>An.</i>	<i>F.V. Tubo çeliku (konduktori) me d=355mm t=5mm</i>	<i>ml</i>	<i>15</i>		
<i>5</i>	<i>An.</i>	<i>Shpim pusi d=311mm me argjila betonite</i>	<i>ml</i>	<i>105</i>		
<i>6</i>	<i>An.</i>	<i>F.V. Tubo çeliku galvanizë d=200mm t=4mm</i>	<i>ml</i>	<i>120</i>		
<i>7</i>	<i>An.</i>	<i>Mbushje e trungut të pusit me granit dhe cimentimi i grykës së pusit</i>	<i>m³</i>	<i>6</i>		
<i>8</i>	<i>An.</i>	<i>Përgatitje argjile betonite</i>	<i>op</i>	<i>21</i>		
<i>9</i>	<i>An.</i>	<i>Larje pusi zevendesimi i argjilës me ujë</i>	<i>op</i>	<i>8</i>		

10	An.	Pompim dhe testim pusi me kompresor dhe pompe thellesie	op	24		
11	An.	Pompim dhe testim pusi me pompe thellesie	op	48		
12	An.	Analizat kimike te ujit	copë	1		
13	An.	Analizat bakterologjike te ujit	copë	1		
14	An.	Pergatitje e grykes se pusit F.V. bryl me fllanxhe d=200mm celiku PN10 bar	copë	1		
15	An.	Vendosje pompe zhytесе me prurje $Q=(5 - 7)$ l/sek; ngritja e pompës $H= (300 - 350)$ mF=20kë + Sistemi automatik i komandimit	copë	1		
		SHUMA I				
1	Pj.	Furnizim pompe zhytесе me prurje $Q=(5 - 7)$ l/sek; ngritja e pompës $H= (300 - 350)$ mF=20kw + Sistemi automatik i komandimit.	copë	2		

si dhe nisur dhe nga specifikimet e këtyre mjeteve: Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s - Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, Matës dixital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin), shoqëria "ALMO KONSTRUKSION" shpk nuk i disponon këto mjete sipas përcaktimeve të kërkuara në DST.

Autoriteti kontraktor nuk ka kryer një vlerësim të drejtë të kësaj procedure mbi këtë pikë diponimin e këtyre mjeteve / pajisjeve.

Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhet të bënte një vlerësim sipërfaqësor të dokumentacionit të paraqitur por duhet të kryente verifikimin/vlerësimin e dokumentacionit të mjeteve të paraqitur për të verifikuar nëse mjetet e paraqitura janë në përputhje me parametrat teknik 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s apo fllanxha DN 100 mm, element këto specifik të kërkuara në DST të kësaj procedure prokurimi

Referuar dhe pikës 6, të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se : Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b" "d " "dh" "e" "h" "i" "j" të pikës 2 të keçtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të oferteës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Komisioni ka anashkaluar verifikimin e dokumentacionit të mjeteve të mësipërme të opertorit ekonomik "ALMO KONTRUKSION" shpk, verifikim i cili dhe me sy të lirë do të ishte i dallueshëm."

Mospërmbushja e kriterit mbi mjetet e mësipërme dhe specifikimeve teknike/parametrave të kërkuara mbi këto lloj mjetesh dhe elementëve të tyre sjell mosplotësimi të kriterit mbi mjetet teknike devijim ky që shkakton pasaktësi në tesimin e prurjes minimale dhe makimale që mund të japë kolona e pusit dhe mospërcaktimin e saktë e të regjimit të punës së pompës zhytëse që do të instalohet dhe balancimin mes prurjeve që vijnë në kolonën e pusit dhe atyre që deërgohen në linjën e transmetimit, mungesa e të cilave kanë ndikim të drejtëpërdrejtë për zbatimin e projekt-preventivit të kësaj kontrate duke shkaktuar dhe dëme teknike dhe mosgarantimin e realizimit me cilësi të punimeve.

Sa më sipër, operatori ekonomik ALMO KONSTRUKSION shpk nuk zotëron kapacitetet e nevojshëm për të plotësuar kriterit teknik mbi 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme të kerkuara, (- Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s, -Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin), Matës dixital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)) të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe për këtë arsye oferta e tij duhet të skualifikohet.”.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1769/2, datë 02.07.2024, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.7. Me shkresën nr. 246/51 prot, datë 09.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1769/3 prot datë 10.07.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, njoftimi lidhur me zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Shqyrtimit të Akneses dhe zgjatjen e afatit të shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK.

II.8. Me shkresën nr. 246/53 prot, datë 11.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1769/4 prot datë 11.07.2024, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit, si dhe vendimi për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, në të cilin konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka pranuar pjesërisht ankesën, si më poshtë vijon:

“... II. Operatori ekonomik ankohet për mangësi në përvojën e mëparshme të ngjashme. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se "Almo Konstruksion ka paraqitur një kontratë të lidhur me Bashkinë Pukë (në rolin e AK); ku vlera pa TVSH ka qënë 77.215 481 lek. Nga ana formale janë plotësuar të gjitha kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit për punë të ngjashme me një ent shtetëror ku janë dorëzuar:

- Vërtetimi i realizimit të kontratës nënshkruar nga AK, kontrata, situacioni përfundimtar, procesverbal kolaudimi, marrje e përkohshme në dorëzim, dhe FTSH.*
- Gjithashtu rezulton se ALMO Konstruksion ka qënë pjesë e BOE sipas kontratës nr 8018 rep, 3230 kol datë 13.12.2019 ku kjo shoqëri ka pasur 49.56% të vlerës së punimeve dhe ka përcaktuar punimet që do të marrë përsipër si linja e dërgimit të ujësjellesit depo Puke dhe linja e brendshme e ujësjellesit. Bazuar në llogaritjen e pjesëmarrjes në këtë BOE dhe zërat e përcaktuar rezulton se Almo Konstruksion ka kryer punime në vlerën 38.267.992 leke pa TVSH, çka detyrimisht plotëson vlerën e kërkuar nga ana jonë si AK për punime të ngjashme në një kontratë të vetme sa 50% e*

fondit limit. Në këto kushte kjo kontratë plotëson kriterin e vlerës dhe ngjashmërisë së punimeve.

Ankuesi pretendon se nuk ka punime ëte ngjashme apo të njëjta sipas preventivit dhe përcakton zëra si: “hapje pusi, reabilitim segmentesh rugore etj”. Në lidhje me pretendimin e punimeve për pus, pavarësisht se OE disponon pikën NS 20-A nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim.

Duhet që OE të paraqesë eksperiencia për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime.

...

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të Ankesës të "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k. në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur" me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", REF-01614-04-16-2024, 76.338.689,55 (shtatëdhjet e gjashtë milion e treqind e tridhjet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjet e nëntë presje pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 10.05.2024.

Pranimin e pretendimit të ankuesit "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k për punimet e mëparshme të ngjashme të "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k, sepse ky operator ekonomik rezulton që nuk ka paraqitur eksperiencia për zërat e pus-shpimit të preventivit.

2. Refuzimin e ankesës të ankuesit "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k për objektin e veprimtarisë të "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k., si të pa bazuara në prova dhe ligj.

3. Refuzimin e ankesës të ankuesit "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k për disponimin e disa mjeteve, makinerive të "ALMO KONSTRUKSION Sh.p.k, si të pa bazuara në prova dhe ligj.

4. T'i propozojë Zyrtarit të Autorizuar të AK UKRK sha, përsëritjen e procedurës, duke u rihedhur me të gjithë specifikimet teknike të nevojshme në zërat e pus-shpimit, pasi konstatohet se specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit përmbajnë mangësi të rëndësishme të specifikimeve teknike të pus-shpimit.

Vendimi i komunikohet menjëherë Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomike të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Vendimi iu komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së çdo vendimi.”.

II.9. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk janë paraqitur argumenta nga ana e operatorëve ekonomikë “ALMO KONSTRUKSION ” SHPK, “XHENGO” SHPK dhe “NDËRTUESI 2014” SHPK lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, si në vijim: “II. Gjithashtu kërkohet të skualifikohet operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k, i cili nuk përmbush kriteret e kualifikimit konkretisht nuk plotëson kriteret si më poshtë:

Së dyti, referuar edhe sa më sipër, ky operator ekonomik nuk plotëson kriteret e kualifikimit pika 2.3.1 të Kapacitetit teknik ku parashikohet se:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 38.169.344,7 lekë pa TVSH dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se 152.677.379 lekë pa TVSH.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasinë e mallrave të furnizuara.

Në këtë procedurë prokurimi parashikohet kryerja dhe realizimi i punime të një natyre komplekse tilla si: shpim pusi, ndërtim godine pusi, ndërtim linje për furnizimin me energji elektrike të stacionit të pompave (Linja ajorore) etj. Në preventivin e kësaj procedure prokurimi përfshihet ndër të tjera dhe ndërtimi i një pusi dhe sisteme komandimi automatik thënë ndryshe sisteme skada, zëra punimesh për të cilat ky operator për shkak të mungesës të realizimit të punëve të ngjashme nuk disponon kontrata të ngjashme që kanë element të njëjtë apo të ngjashëm me zërat të preventivit si psh: Ngritje sonde, hapja e gropës së dekantimit, punime të tjera dhe kthimi i territorit në identitet, Shpim pusi d=311mm me argjila betonite, Furnizim pompe zhytëse + Sistemi automatik i komandimit etj.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Me shkresën nr. 246/53 prot., datë 11.07.2024, protokolluar me tonën me nr.1769/4 prot, datë 11.07.2024 “VENDIM NR. I”, autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik Vendimin e KSHA-së për shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK.

Referuar shkresës së mësipërme të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht atë si më poshtë vijon:

“... II. Operatori ekonomik ankohet për mangësi në përvojën e mëparshme të ngjashme. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar rezulton se "Almo Konstruksion ka paraqitur një kontratë të lidhur me Bashkinë Pukë (në rolin e AK); ku vlera pa TVSH ka qënë 77.215 481 lek. Nga ana formale janë plotësuar të gjitha kërkesat për paraqitjen e dokumentacionit për punë të ngjashme me një ent shtetëror ku janë dorëzuar:

- Vërtetimi i realizimit të kontratës nënshkruar nga AK, kontrata, situacioni përfundimtar, procesverbal kolaudimi, marrje e përkohshme në dorëzim, dhe FTSH.
- Gjithashtu rezulton se ALMO Konstruksion ka qënë pjesë e BOE sipas kontratës nr 8018 rep, 3230 kol datë 13.12.2019 ku kjo shoqëri ka pasur 49.56% të vlerës së punimeve dhe ka përcaktuar punimet që do të marrë përsipër si linja e dërgimit të ujësjellesit depo Puke dhe linja e brendshme e ujësjellesit. Bazuar në llogaritjen e pjesëmarjes në këtë BOE dhe zërat e përcaktuar rezulton se Almo Konstruksion ka kryer punime në vlerën 38.267.992 leke pa TVSH, çka detyrimisht plotëson vlerën e kërkuar nga ana jonë si AK për punime të ngjashme në një kontratë të vetme sa 50% e fondit limit. Në këto kushte kjo kontratë plotëson kriterin e vlerës dhe ngjashmërisë së punimeve.

Ankuesi pretendon se nuk ka punime ëte ngjashme apo të njëjta sipas preventivit dhe përcakton zëra si: “hapje pusi, reabilitim segmentesh rugore etj”. Në lidhje me pretendimin e punimeve për pus, pavarësisht se OE disponon pikën NS 20-A nuk ka arritur të paraqesë punime për zërat e preventivit pus-shpim.

Duhet që OE të paraqesë eksperiencia për të gjitha zërat e preventivit përfshirë edhe pus-shpime.

...

VENDOSI:

1. Pranimin pjesërisht të Ankesës të "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k. në procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur" me objekt: "Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë", REF-01614-04-16-2024, 76.338.689,55 (shtatëdhjet e gjashtë milion e treqind e tridhjet e tetë mijë e gjashtëqind e tetëdhjet e nëntë presje pesëdhjet e pesë) lekë pa TVSH, e zhvilluar në datën 10.05.2024.

Pranimin e pretendimit të ankuesit "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k për punimet e mëparshme të ngjashme të "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k, sepse ky operator ekonomik rezulton që nuk ka paraqitur eksperiencia për zërat e pus-shpimit të preventivit.

2. Refuzimin e ankesës të ankuesit "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k për objektin e veprimtarisë të "ALMO KONSTRUKSION" Sh.p.k., si të pa bazuara në prova dhe ligj.

3. Refuzimin e ankesës të ankuesit "ED KONSTRUKSION" Sh.p.k për disponimin e disa mjeteve, makinerive të "ALMO KONSTRUKSION Sh.p.k, si të pa bazuara në prova dhe ligj.

4. T'i propozojë Zyrtarit të Autorizuar të AK UKRK sha, përsëritjen e procedurës, duke u rihedhur me të gjithë specifikimet teknike të nevojshme në zërat e pus-shpimit, pasi konstatohet se specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit përmbajnë mangësi të rëndësishme të specifikimeve teknike të pus-shpimit.

Vendimi i komunikohet menjëherë Zyrtarit të Autorizuar të Autoritetit Kontraktor.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomike të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Vendimi iu komunikohet të gjitha subjekteve të përfshira në proces, jo më vonë se ditën e nesërme të punës pas marrjes së çdo vendimi.”.

III.1.2. Në nenin 30, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash.

Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.3. Neni 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet shprehimisht se:

“1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën për dokumentet e tenderit dhe në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit kur nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon procedurën për pjesën tjetër të ankesës dhe me mbylljen e shqyrtimit të çështjes duhet të shprehet me vendimmarrje deklarative për pjesën e pranuar sipas parashikimeve të shkronjës “ç” të pikës 2 të nenit 118 të këtij ligji, së bashku me vendimmarrje për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

4. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor nuk ka marrë vendim sipas përcaktimeve të nenit 114 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik menjëherë, por, në çdo rast, jo më vonë se 3 ditë nga mbarimi i afatit të mësipërm, i kërkon dërgimin e informacionit apo dokumentacionit përkatës. Në këtë rast, autoriteti ose enti kontraktor, brenda 3 ditëve nga marrja dijeni, ka detyrimin të paraqesë në Komisionin e Prokurimit Publik informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar.

Për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, Komisioni i Prokurimit Publik merr vendim jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së informacionit apo dokumentacionit nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është jo më vonë se 20 ditë.

5. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës Komisioni i Prokurimit Publik ka nevojë të kërkojë ekspertizë nga palë të treta ose të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 4 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Afati për marrjen e vendimit nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast Komisioni i Prokurimit Publik ka detyrimin të vërë në dijeni palët.”.

Sa më sipër KPP gjykon, se duke qenë se autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr. 246/53 prot, datë 11.07.2024, ka pranuar njërin nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ofertues “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, në mbështetje të nenit 115 pika 3 të Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni Prokurimit Publik vendos të mbyllë çështjen për këtë pretendim të ngritur në ankesën e operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, si në vijim: “II. Gjithashtu kërkojmë të skualifikohet operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k, i cili nuk përmbush kriteret e kualifikimit konkretisht nuk plotëson kriteret si më poshtë:

Së pari, operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” sh.p.k nuk plotëson kriterin mbi fushën e veprimtarisë sipas objektin të prokurimit ku kjo procedurë prokurimit ka si objekt punime ndërtimi në ujësjellës.

Referuar, Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP) në DST e kësaj procedure prokurimi përcaktohet : 45247130-0 Punime ndërtimi për ujësjellës.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në Seksionin 2 “Objekti i kontratës” të dokumentave të tenderit të modifikuara autoriteti kontraktor ka përcaktuar objektin e prokurimit si më poshtë:

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: *“Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”*

III.2.2. Në shtojcën 7 “Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të modifikuara autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

“1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;”.

III.2.3. Në shtojcën 7 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 1/a “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të modifikuara autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë vijon:

“I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8. ”

III.2.4. Në dokumentat e tenderti të modifikuara të publikuara në Sistemin Elektronik të Prokurimit (SPE) nga ana e autoritetit kontraktor, pjesë përbërëse është edhe Shtojcën nr. 8 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, si më poshtë vijon:

Shtojca 8

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)
FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT – i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar

<ul style="list-style-type: none"> <i>Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik</i> 			
<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p>etj.</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____</p>

Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.

Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Ne cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, në mbështetje të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe në mbështetje të Ligjit Nr.9121/2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", bëj këtë deklaram dhe garantoj se deklaratat e mëposhtme janë të vërteta dhe të plota në çdo aspekt:

- 1. Unë kam lexuar dhe kuptuar përmbajtjen e kësaj Deklarate;*
- 2. Unë kuptoj që oferta e paraqitur do të s'kualifikohet dhe/ose përjashtohet nga fitimi i kontratave publike, nëse kjo Deklaratë vërtetohet se nuk është e plotë dhe / ose e saktë në çdo aspekt;*
- 3. Unë jam i autorizuar nga Ofertuesi të firmos këtë Deklaratë dhe të paraqes ofertë në interes të Ofertuesit;*
- 4. Çdo person, firma e të cilit shfaqet në dokumentacionin e ofertës, është i autorizuar nga Ofertuesi për të përgatitur dhe për të nënshkruar ofertën në interes të Ofertuesit;*
- 5. Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, unë kuptoj që fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që:*
 - a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor;*
 - b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.*
- 6. Ofertuesi deklaron se: (kliko një nga alternativat e mëposhtme):*

- a) Ofertuesi ka përgatitur ofertën e tij në mënyrë të pavarur, pa u konsultuar, pa komunikuar dhe pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër;
-
- b) Ofertuesi është konsultuar, ka komunikuar, ka bërë marrëveshje me një ose më shumë konkurrentë në lidhje me këtë procedurë prokurimi. Ofertuesi deklaron se në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).
-
7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
- a) çmimet ;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të

administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

*Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.***

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.*
- Operatori ekonomik _____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.*
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nejjshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.*

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: <u>Profili i punonjësve</u> <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.
- Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.2.5. Për përmbushjen e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikat 1/a dhe 1/e “KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT” të Shtojcën 7 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit”, operatori ekonomik ofertues “ALMO KONSTRUKSION” SHPK ka dorëzuar në dokumentacionin e ofertës Shtojcën 8 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” ku në seksionin A: “DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITERËVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
<p>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: XXX</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>
<p>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda</p>

<p>operatorit ekonomik, si më poshtë:</p> <p>1. XXX</p> <p>2. XXX</p> <p>nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme: XXX</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>
<p>Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>
<p>Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.</p> <p>Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>
<p>Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>
<p>Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së.</p> <p>Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.</p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme XXX</i></p>

- **EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”, datë 27.04.2024, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, nëpërmjet shërbimeve elektronike në platformën E-albania, ku në seksionin “9. Objekti i aktivitetit” konstatohet se objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është si në vijim: “Ndërtime civile, tregti me shumicë e pakicë, import, eksport i mallrave industriale, ndërtimi, etj. Prodhim produkte të ndryshme betoni. Grumbullim dhe transportim të mbetjeve jo të rrezikshme. Transport ndërkombëtar mallrash për vete për të tretët dhe me qera .**

III.2.6. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.2.7. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, konkretisht në shtojcën 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, “Kapaciteti ligjor/profesional”, autoriteti kontraktor, ka kërkuar shprehimisht që objekti i prokurimit të jetë i pasqyruar në ekstraktin e gjendjes aktuale të shoqërisë, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, në objektin e veprimtarisë së saj, konkretisht: *“Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK rezulton, se ka paraqitur ekstraktin e regjistrimit tregtar, në të cilin konstatohet të ketë objekt të veprimtarisë, si në vijim: *“Ndërtime civile”*, objekt aktiviteti i cili përfshin dhe objektin e prokurimit dhe konkretisht: *“Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë”*, ashtu siç është kërkuar në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, pasi nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK plotësohet kërkesa për objektin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me objektin e prokurimit, sipas kriterit të përcaktuar në dokumentet e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes "ED KONSTRUKSION" nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "ED KONSTRUKSION" SHPK, për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" SHPK, si në vijim: "Së treti, operatori ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" shpk nuk plotëson kriterin mbi 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme të kërkuara. Operatori ekonomik nuk plotëson kriterin mbi mjetet të kërkuara në shtojcën e publikuar, Shtojca 7/2 "FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT SHITESË" ku është kërkuar si më poshtë:

Mjetet	Statusi	Sasia
Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)	në pronësi ose me qira	Copë 1

Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s - kërkohet për testimin e prurjes minimale dhe maksimale që mund të japë kolona e pusit. Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin) - kërkohet për matjen e prurjes minimale dhe maksimale që mund të japë kolona e pusit.

Shërben gjithashtu dhe për përcaktimin e saktë të regjimit të punës së pompës zhytëse që do të instalohet dhe balancimin mes prurjeve që vijnë në kolonën e pusit dhe atyre që dërgohen në linjën e transmetimit.

Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin) kërkohet për matjen e nivelit dinamik të pusit. Niveli dinamik janë luhatjet e nivelit të ujit në kolonën e pusit. Njohuritë e sakta për nivelin dinamik ndikojnë drejtpërdrejt në shfrytëzimin korrekt të pusit dhe përcaktimin e një regjimi optimal të pompës zhytëse në vazhdim. Këto mjete shitesë janë në përputhje me zërat e punimeve që ndodhen në preventivë. (shkëputur nga Shtojca)

Operator ekonomik "ALMO KONSTRUKSION" SHPK nuk dispon mjetet e mësipërme.

Ky operator ekonomik nuk objekt veprimtarie të kësaj procedure prokurimi, nuk ka eksperience mbi kryerjen e punëve të ngjashme në drejtimin e objekteve të prokurimit mbi ujesjellsa, si dhe

nisur dhe me kohën e publikimit të kësaj shtojce, mbi kërkesën për disponimin e këtyre mjeteve

verteton faktin se operatori i kualifikuar nuk i disponon këto mjete.

Referuar dhe preventivit të punimeve përcaktohet:

Nr	Nr. Analize	Emërtimi i punimeve civile	Njësi	Sasia	Çmimi (lekë)	Vlera (lekë)
		Shpim pusi				
1	An.	Transport i agregatit të shpimit dhe bazës materiale vajtje kthim	ml	120		
2	An.	Punime përgatitore (Ngritje sonde hapja e gropës së dekantimit punime të tjera dhe kthimi i territorit në identitet)	komplet	120		
3	An.	Shpim pusi d=470mm për konduktorin	ml			

				15		
4	An.	F.V. Tubo celiku (konduktori) me $d=355\text{mm}$ $t=5\text{mm}$	ml	15		
5	An.	Shpim pusi $d=311\text{mm}$ me argjila betonite	ml	105		
6	An.	F.V. Tubo celiku galvanize $d=200\text{mm}$ $t=4\text{mm}$	ml	120		
7	An.	Mbushje e trungut te pusit me granil dhe cimentimi i grykes se pusit	m^3	6		
8	An.	Pergatitje argjile betonite	op	21		
9	An.	Larje pusi zevendesimi i argjiles me uje	op	8		
10	An.	Pompim dhe testim pusi me kompresor dhe pompe thellesie	op	24		
11	An.	Pompim dhe testim pusi me pompe thellesie	op	48		
12	An.	Analizat kimike te ujit	copë	1		
13	An.	Analizat bakterologjike te ujit	copë	1		
14	An.	Pergatitje e grykes se pusit F.V. bryl me flanaxhe $d=200\text{mm}$ celiku PN10 bar	copë	1		
15	An.	Vendosje pompe zhytесе me prurje $Q=(5 - 7)$ l/sek; ngritja e pompës $H= (300 - 350)$ mF=20kë + Sistemi automatik i komandimit	copë	1		
		SHUMA I				
1	Pj.	Furnizim pompe zhytесе me prurje $Q=(5 - 7)$ l/sek; ngritja e pompës $H= (300 - 350)$ mF=20kw + Sistemi automatik i komandimit.	copë	2		

si dhe nisur dhe nga specifikimet e këtyre mjeteve: Elektropompë zhytесе për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s - Matës uji elektromekanik me flanaxha DN 100 mm, Matës dixital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin), shoqëria "ALMO KONSTRUKSION" shpk nuk i disponon këto mjete sipas përcaktimeve të kërkuara në DST.

Autoriteti kontraktor nuk ka kryer një vlerësim të drejtë të kësaj procedure mbi këtë pikë diponimin e këtyre mjeteve / pajisjeve.

Komisioni i vlerësimit të ofertave nuk duhet të bënte një vlerësim sipërfaqësor të dokumentacionit të paraqitur por duhet të kryente verifikimin/vlerësimin e dokumentacionit të mjeteve të paraqitur për të verifikuar nëse mjetet e paraqitura janë në përputhje me parametrat teknik 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s apo flanaxha DN 100 mm, element këto specifik të kërkuara në DST të kësaj procedure prokurimi

Referuar dhe pikës 6, të Vendimit të Keshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku parashikohet se : Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b" "d " "dh" "e" "h" "i" "j" të pikës 2 të keëtij neni, si dhe dokumentet e tjera

shoqëruese të oferteës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Komisioni ka anashkaluar verifikimin e dokumentacionit të mjeteve të mësipërme të operatorit ekonomik "ALMO KONTRUKSION" shpk, verifikim i cili dhe me sy të lirë do të ishte i dallueshëm."

Mospërmbushja e kriterit mbi mjetet e mësipërme dhe specifikimeve teknike/parametrave të kërkuara mbi këto lloj mjetesh dhe elementëve të tyre sjell mosplotësimi të kriterit mbi mjetet teknike devijim ky që shkakton pasaktësi në tesimin e prurjes minimale dhe maksimale që mund të japë kolona e pusit dhe mospërcaktimin e saktë e të regjimit të punës së pompës zhytëse që do të instalohet dhe balancimin mes prurjeve që vijnë në kolonën e pusit dhe atyre që deërgohen në linjën e transmetimit, mungesa e të cilave kanë ndikim të drejtëpërdrejtë për zbatimin e projekt-preventivit të keësaj kontrate duke shkaktuar dhe dëme teknike dhe mosgarantimin e realizimit me cilësi të punimeve.

Sa më sipër, operatori ekonomik ALMO KONSTRUKSION shpk nuk zotëron kapacitetet e nevojshëm për të plotësuar kriterit teknik mbi 2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme të kërkuara, (- Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s, -Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin), Matës dixital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)) të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe për këtë arsye oferta e tij duhet të skualifikohet.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 "Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit" pika 2.3.6 "KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT" autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë vijon:

"2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Statusi	Sasia
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Copë 1
Eskavator me çekiç	në pronësi ose me qira	Copë 2
Fadrome me goma (bobcat apo ekuivalente)	në pronësi ose me qira	Copë 1
Minieskavator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 2
Kamion vetshkarkues me kapacitet mbajtes nga 10 deri 20 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamion me vinç	në pronësi ose me qira	Copë 1
Kamionçinë deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobitumatriçe	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobot Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Autopompe betoni	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motobetoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Pompe Uji	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Motogenerator / Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Sondë për shpime horizontale per kalim tubash nen trasene e rrugës	në pronësi ose me qira	Copë 1
Aparature elektronike per kontrollin e presionit , pompe	në pronësi ose me qira	Copë 1

<i>presioni deri 40bar per te realizuar procedure e testeve te presionit</i>		
<i>Makine/aparat per ngjitje tubash koke me koke</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Aparat per ngjitje tubash me elektrofuzion</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Kompresor ajri</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Kontenier ndertimi stacionar (zyre)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Tokmak elektrik</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Grejder</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Rul</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Autosondë për hapje pusi dhe vendosjen e tubave në pus</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Kompresor për futjen me presion të ajrit dhe solucionit në pus</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Asfaltoshtruese</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Matrapik</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Rimorkiator</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Fabrikë asfalti, me vendndodhje në distancë teknikisht të pranueshme nga objekti.</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Fabrikë betoni pajisur me lejë mjedisore</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Dumper</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>
<i>Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)</i>	<i>në pronësi ose me qira</i>	<i>Copë 1</i>

Shënim: Për këtë pikë operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e VETËDEKLARIMIT sipas shtojcës nr.8.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, që operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë dokumentat provues :

a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik; d) siguracionin e mjetit, (I vlefshëm).

Për mjetet e siguruar me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracionin e mjetit, (I vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontratën perkatese të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt I këtij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.

Autoriteti Kontraktor UKKO S.H.A rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara nga OE.

III.3.2. Referuar nenit 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar përcaktohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

III.3.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të modifikuara dhe konkretisht i shtojcës 7 të këtyre dokumentave, Komisioni konstaton, se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar që ofertuesit pjesmarrës në procedurë të dëshmojnë se disponojnë mjetet e dhe pajisjet e kërkuara në kriterin kualifikues të pikës 2.3.6 të shtojcës 7 të dokumentave të tenderit të modifikuara, ku për për të dëshmuar këtë disponim duhet të dorëzojnë në fazën e ofertimit Shtojcën 8 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*”, ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari për të vërtetuar se disponon mjetet e kërkuara duhet të paraqesë dokumentacionin si në vijim; “ a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (I vlefshëm).

Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij; b) leje qarkullimi; c)çertifikaten e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(I vlefshëm). Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt I ketij prokurimi.

b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme targa e mjetit.”, ndërkohë që për pajisjet si në vijim: “Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s; Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin) dhe Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)”, nuk është kërkuar që të paraqitet asnjë dokumentacion vërtetues dhe për më tepër nuk është kërkuar ndonjë dokumentacion specifik që të dëshmojë përmbushjen e specifikimeve teknike të këtyre pajisjeve dhe konkretisht të parametrave si në vijim: “ ‘ngritje minimale 100 m’ dhe “prurje maksimale 7 l/s” për pajisjen “Elektropompë zhytëse”; me “fllanxha DN 100 mm” dhe “i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)” për pajisjen “Matës uji elektromekanik” dhe paramerin Teknik “i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)” për pajisjen “Matës dixhital i nivelit dinamik të posit”.”.

Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kriterëve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve.

Pra, nga ana e autoritetit kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit të përcaktuar në pikën 2.3.6 të shtojcës 7 nuk është kërkuar që të paraqitet asnjë dokumentacion vërtetues për disponimin e pajisjeve si në vijim: “Elektropompë zhytëse për testimin e pusit me ngritje minimale 100 m dhe prurje maksimale 7 l/s; Matës uji elektromekanik me fllanxha DN 100 mm, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin) dhe Matës dixhital i nivelit dinamik të pusit, i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)” dhe për më tepër nuk është kërkuar ndonjë dokumentacion specifik që të dëshmojë përmbushjen e specifikimeve teknike të këtyre pajisjeve dhe konkretisht të parametrave si në vijim: “ ‘ngritje minimale 100 m’ dhe “prurje maksimale 7 l/s” për pajisjen “Elektropompë zhytëse”; me “fllanxha DN 100 mm” dhe “i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)” për pajisjen “Matës uji

elektromekanik” dhe paramerin Teknik “i përshtatur që të lidhet me kompjuterin (laptopin)” për pajisjen “Matës dixhital i nivelit dinamik të posit”.

Për sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimi i ankimuesit se shoqëria “ALMO KONSTRUKSION” SHPK nuk disponon pajisjet e sipërpërmendura, si dhe këto pajisje nuk janë sipas specifikimeve teknike nuk qëndron, pasi këto pretendime janë ngritur duke ju referuar një kriteri kualifikues të pa kërkuar, çka nuk është në përputhje me ligjin për prokurimin publik.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK mbi shoqërinë “XHENGO” SHPK dhe “NDËRTUESI 2014” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 10.06.2024, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK mbi shoqëritë “XHENGO” SHPK dhe “NDËRTUESI 2014” SHPK nuk do të merret në shqyrtim.

III.5. Në lidhje me vendimin nr. 246/53 prot, datë 11.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1769/4 prot datë 11.07.2024, të komisionit të shqyrtimit të ankesës, përsa i përketë pikës 4 të dispozitivit të këtij vendimi, para shqyrtimit në themel të kësaj pike, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga pretendimet e ngritura në ankesë nga ana e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor rasti konkret KSHA gjatë shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Referuar informacionit të autoritetit kontraktor protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik me shkresën nr. 246/53 prot, datë 11.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1769/4 prot datë 11.07.2024, si dhe ankesës së operatorit ekonomik ankimues rezulton, se Komisioni Shqyrtimit të Ankesës, pasi mori në trajtim ankesën e operatorit ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK me vendimin nr. 1, datë 11.07.2024 ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, ndërsa në pikën 4 të dispozitivit të këtij vendimi ka vendosur si në vijim: “4. T’i propozojë Zyrtarit të Autorizuar të AK UKRK sha, përsëritjen e procedurës, duke u rihedhur me të gjithë specifikimet teknike të nevojshme në zërat e pus-shpimit, pasi

konstatohet se specifikimet teknike të dokumenteve të tenderit përmbajnë mangësi të rëndësishme të specifikimeve teknike të pus-shpimit.”.

III.5.1. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

Në nenin 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” pika 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se komisioni i shqyrtimit të ankesë në përfundim të shqyrtimit të saj ka të përcaktuar këto tagra në lidhje me vendimarrjen e tij:

“3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.”.*

III.5.2. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesë pranë autoriteti kontraktor ka tejkalluar objektin e ankesës, pasi në ankesën e tij operatori ekonomik ankimues “ED KONSTRUKSION” SHPK nuk ka kërkuar anullimin e kësaj procedure prokurimi, ndërkohë që në rastin konkret KPP vëren se autoriteti kontraktor ka patur momenti procedural dhe mundësin për të konstatuar faktin e përmëndur në pikën 4 të dispozitivit të vendimit nr. 1, datë 11.07.2024, të Komisionit të shqyrtimit të Ankesës dhe akoma më tej vetë ky komision në arsyetimin e bërë nga njëra anë parashtron mundësin se këto zëra mund të

prokurohen si zëra më vetë dhe nga ana tjetër propozon anulimin e procedurës dhe rihedhjen e saj, pra nga sa më sipër vetë ky komision bie në kontradiktë dhe ndesh me qëllimet e LPP siç është rritja e efikasitetit dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, si dhe të sigurimit të integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik. Pra nga sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuar në LPP edhe pse e ka patur këtë mundësi, por në përfundim të të gjithë procedurës së prokurimit dhe pas ankesës së një operatori ekonomik të interesuar pretendon që të anulojë procedurën, kur ndërkohë vetë komisioni propozon se disa zëra të preventivit mund të prokurohen edhe më vite, pra duke lënë të nënkuptojë që nuk ndikojnë në procedurën objekt ankimi. Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për tu ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore, ku veprimi procedural i KSHA-së në rastin konkret është tej objektit të ankesës. KPP e gjykon, të gabuar si në zbatimin ashtu dhe interpretimin e ligjit në rastin konkret nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në respektim të dispozitave të mësipërcituara sikundër rezulton, nga faktet e parashtruara më sipër, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar hapat proceduralë të parashikuar nga ligji, duke ndërmarrë vendime tej objektit të ankesës. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se pika 4 e dispozitivit të vendimit të KSHA-së nr. 1, datë 11.07.2024, në lidhje me propozimin për anulimin e procedurës do të konsiderohen si akt absolutisht të pavlefshme në kuptim të nenit 108 të ligjit nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”. Gjithashtu, në nenin 111 të K.Pr.A parashikohet se: “*Organi publik ka detyrimin të konstatojë pavlefshmërinë absolute të aktit administrativ nëse vjen në dijeni për rastet e parashikuara në nenin 108 të këtij Kodi*”. Ndër karakteristikat thelbësore të veprimit juridik absolutisht të pavlefshëm përmendim: (i) *veprimi juridik që është absolutisht i pavlefshëm nuk shkakton pasojat juridike që synojnë palët; (ii) ai nuk ka fuqinë juridike të një veprimi juridik të vlefshëm; (iv) veprimi juridik i pavlefshëm nuk mund të bëhet i vlefshëm me asnjë veprim të mëpasshëm, as edhe kur ekziston vullneti i palëve (me aprovim, miratim), as me kalimin e kohës së parashkrimit dhe as me zhdukjen më vonë të shkakut të pavlefshmërisë (quod ab initio vitiosum est tractu temporis convallescere non potest)*. Komisioni i Prokurimit Publik në interpretim sistematik (domethënien e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykon se ndodhet para kushtit të konstatimit prima facia të një akti administrativ pjesërisht të pavlefshëm dhe në cilësinë e organit administrativ më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, parashikuar nga neni 24/1 i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, konstaton se pika 4 e dispozitivit të vendimit të marrë nga ana e KSHA-së në lidhje me propozimin për të anuluar procedurën e prokurimit është akt administrativ absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 108 të K.Pr.A.

Sa më sipër, referuar nenit 110 të KPrA në të cilën parashikohet se: “*Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm nuk sjell asnjë pasojë juridike, pavarësisht faktit nëse është konstatuar apo jo si i tillë. Ai konsiderohet se nuk ekziston*.”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, pika 4 e dispozitivit të vendimit të marrë nga ana e KSHA-së në lidhje me

propozimin për të anuluar procedurën e prokurimit cenon në thelb jo vetëm garancitë procedurale të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, por njëherazi cenojnë edhe parimin e sigurisë juridike. Në jurisprudencën e saj *Inter Allia*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë në vendimin nr. 12/2014 datë 17.03.2014 është shprehur se: “*Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit tek shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin*”. Sa më sipër, KPP gjykon, se në rastin konkret parimi i sigurisë juridike në kuptimin material të tij, konsiderohet edhe moscenimi i të drejtave të fituara dhe i pritshmërive të ligjshme që garantojnë aktet në fuqi. Akoma më tej, në jurisprudencën e saj, Gjykata Kushtetuese *Inter Allia* në vendimin 15/2010 ka theksuar se “*parimi i shtetit të së drejtës i sanksionuar në nenin 4 të Kushtetutës nënkupton veprimin e të gjithë institucioneve shtetërore sipas së drejtës në fuqi si dhe supremacinë e Kushtetutës ndaj akteve të tjera normative. Çdo organ në një shtet të së drejtës duhet të veprojë për aq sa i lejon Kushtetuta dhe ligji duke mos i tejkaluar kufijtë e përcaktuar prej tyre. Në këtë kuptim, çdo institucion shtetëror duhet të ketë të përcaktuar qartë fushën e kompetencave të veta brenda të cilave është i autorizuar të veprojë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore*”.

Sa më sipër, K.P.P. konstaton, se pika 4 e vendimit të KSHA-së është në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon LPP, ndaj ky vendim duhet të anulohet si vendim i dalë në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “*Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në 10 një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik*”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “*ED KONSTRUKSION*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.
2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*ED KONSTRUKSION*” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*” me Nr. REF-01614-04-16-2024, me objekt: “*Rikonstruksioni i skemave të furnizimit me ujë për fshatrat Kuç i Zi dhe Belorta, Bashkia Korçë*”, me fond limit 76.338.689,55lekë pa TVSH, zhvilluar më

datë 10.05.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë SH.A.

3. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit, duke skualifikuar operatorin ekonomik “ALMO KONSTRUKSION” SHPK, në zbatim të pikës 1 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave.
4. Të konstatoj absolutisht të pavlefshëm pikën 4 të dispozitivit të vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës të datës 11.07.2024 për anulimin e procedurës, të marrë në kundërshtim me hapat proceduralë që parashikon ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ED KONSTRUKSION” SHPK.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Nënkryetar
Fiorent Zguro

